

20110471314

L I G J
PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR NGARKIM TË REPUBLIKES SË MAQEDONISE
ME HUA TE BANKA JAPONEZE PËR BASHKEPUNIM NDERKOMBETAR SIPAS
MARREVESHJES PËR HUA PËR REALIZIMIN E "PROJEKTIT PËR
PERMIRESIMIN E SHFRYTEZIMIT TË UJIT NË BASENIN E LUMIT ZLETOVICE"

Neni 1

Në Ligjin për ngarkim të Republikës së Maqedonise me hua te Banka Japoneze për Bashkepunim Nderkombetar sipas Marreveshjes për hua për realizimin e "Projektit për permiresimin e shfrytezimit të ujit në basenin e lumit Zletovica" ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonise" numer 72/2003 dhe 103/2008), në nenin 3 paragrafin 2 fjalet: "Në grejs periudhen prej shtate vitesh" zevendesohen me fjalet: "Në periudhe prej nente vitesh".

Neni 2

Neni 5 ndryshohet si vijon:

"Shfrytezues perfundimtare të mjeteve të huas nga neni 1 i ketij ligji jane Ndermarrja Publike "Zletovica" dhe komunat që jane pjese e HS Zletovica, që i plotesojne kushtet për ngarkim me borxh në pajtim me Ligjin për borxh publik dhe Ligjin për financimin e njesive të vetadministrimit lokal.

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndersjella, Republika e Maqedonise e perfaqesuar nga Ministria e Financave dhe shfrytezuesit perfundimtare të mjeteve të huas, do të lidhin marreveshje të vecanta për hua".

Neni 3

Neni 6 ndryshohet si vijon:

"Republika e Maqedonise huan nga neni 1 i ketij ligji do ta paguaje nga mjetet që do të grumbullohen nga shfrytezuesit e mjeteve të huas nga neni 5 i ketij ligji. "

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise".